

Ekskluzive

Ekskluzive | Të shtëna me armë te një lokal në Fushë Kosovë – 24-vjeçari ikën me Audi, më pas dorëzohet vetë në Polici



Sinjali.com

15 Gusht 2026 11:41



Të shtëna me armë janë raportuar mbrëmjen e së premtes pranë një lokali në Rugën e Pejës në Fushë Kosovë, ndërsa personi i dyshuar fillimisht është larguar nga vendi i ngjarjes me veturë dhe më pas është vetëdorëzuar në Polici, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është Ramadan Brahimi, rreth 24-vjeçar.

Rasti ka ndodhur më 14 gusht, rreth orës 21:50, ndërsa Policia është njoftuar pak minuta më vonë se pranë një lokali në Rugën e Pejës kishte pasur të shtëna me armë.

Njësitet policore kanë dalë menjëherë në vendin e ngjarjes, por personi i dyshuar tashmë ishte larguar me një Audi ngjyrë hiri, në drejtim të Komoranit.

Policia ka verifikuar targat e automjetit dhe ka arritur të identifikojë pronarin. Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, pas kontaktimit nga Policia, Brahimi ka pranuar se kishte shtënë me armë.

24-vjeçari më pas është paraqitur vetë në Stacionin Policor në Drenas, ku ka dorëzuar edhe armën që dyshohet se ishte përdorur – një pistoletë “BLOW-F92”, së bashku me një karikator dhe dy fishekë me gaz të kalibrit 9 mm.

Arma është sekuestruar, ndërsa Brahimi është shoqëruar në Stacionin Policor në Fushë Kosovë, ku është intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës.

Për rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit nga Departamenti i Përgjithshëm, i cili ka urdhëruar iniciimin e rastit për “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm”.

Pas përfundimit të procedurave, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera